

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“2 H Company“ sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 15.02.2022, unë Klevis Shametaj, lindur me 26.07.1999, shtetas shqiptar, banues në Tirane, Rruga “Rruga e Kavajes”, njesia administrative nr.10, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar sipas pasaportës Nr BA2068665, i cili me cilesine e “ortakut themelues “ deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “2 H Company“ sh.p.k .

KREUI

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “2 H Company“ sh.p.k, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).


Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “2 H Company“ shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Klevis Shametaj, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne TIRANE, Fshati Ahmetaq, pasuria me numer 65/16-1, vol 10, fq 247, zona kadastrale 1006.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Tregtim me shumice dhe pakice i te gjitha materialeve, veglave dhe aparaturave te pastrimit, dezinfektimit dhe higjienizimit. Tregtim me shumice dhe pakice te detergjenteve te llojeve te ndryshme, produkteve kozmetike dhe te lendeve te para te ndryshme per fushen e kimise industriale. Tregtim i pajisjeve dhe aparaturave mjekesore, bazave materiale dhe aksesoreve ndihmes ne kete fushe. Sherbime te pastrimit, dezinfektimit dhe deratimit te zyrave, enteve shtetore dhe private, ambienteve publike dhe private.

Tregtim i te gjitha tipeve te mobilieve industriale, mjekesore, per zyra, hotele, shkolla, ente shtetore apo private, se bashku dhe me aksesoret e tyre, si dhe sherbimin e riparim-mirembajtjes se tyre.

Tregtimi te gjitha materialeve dhe sistemeve elektrike, hidraulike, industriale, pjeseve te kembimit per aparatura dhe makineri, baterive industriale, gjeneratoreve dhe transformatoreve te fuqive dhe perdorimeve te ndryshme. Tregtimi i te gjitha llojeve te pajisjeve, veglave dhe aparaturave per nenstacionet elektrike te prodhimit, shperndarjes dhe administrimit. Tregtimi i celave, paneleve dhe releve te mbrojtjes dhe komandimit, pjeseve te kembimit, sherbime dhe mirembajtje te ketyre sistemeve.

Tregtimin e te gjitha materialeve dhe makinerive te ndertimit, veglave te punes, bojrave.

Tregtimin e te gjitha tipeve te pajisjeve elektroshtepiake, pajisjeve mobiluese, veshjeve industriale, materialeve te buta, uniformave te te gjitha llojeve, veshjeve speciale te punes, si dhe ato te kujdesit personal.

Tregtim dhe sherbime te te gjitha pajisjeve dhe sistemeve te teknologjise se informacionit. Projektme te sistemeve kompjuterike, zhvillim dhe mirembajtje e tyre. Tregtim i pajisjeve kompjuterike, kompjuterave te tipeve dhe sherbimeve te ndryshme, fotokopjueseve, printerave, kamerave, sistemeve te video konferencave dhe perkthimeve simultane, te sistemeve audio dhe video sipas kerkesave, te kancelarive dhe aksesoreve perkates. Tregtimin e te gjitha pajisjeve dhe aparaturave te sigurise se ambienteve, zyrave, shkollave dhe enteve te ndryshme.


Organizime festash private dhe shtetore, ngjarjesh ceremoniale, mundesi dheniesh te ambienteve me qira apo ne shfrytezim per keto ceremoni. Tregtimin e te gjitha materialeve dhe veglave qe sherbejne per te tilla organizime, perfshire dhe produktet piroteknike.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore : Pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II
KAPITALI



Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem " i shoqerise :

Klevis Shametaj zoterues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 200 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit Nr.43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II


ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te



pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte **Klevis Shametaj**, emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje.


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :



sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto akt themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14



Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "2 H Company" *sh.p.k* , nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEM

Klevis Shametaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Klevis Shametaj', written in a cursive style.